



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria
 Vlada-Government
 Ministria e Ekonomisë
 Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
 MINISTRIA E EKONOMISE
 MINISTARSTVO EKONOMIJE
 MINISTRY OF ECONOMY

Nr. Prot. 0113
 Nr. Prot. 103
 Nr. i Regjistrimit 2
 Data 21.01.22
 PRISHTINE A NO.1

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data. 21.01.2022
 Datum.
 Date.

Njesia organizative	Nr. i Lëndës	Vlera
-VI-	020-984/8	

DATA	19.01.2022
PËR/ZATO:	Z.Besim Myrtezani,zv.udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave/MAPL
CC:	Kryetari i Komunës së Obiliqit Znj.Venera Çerkini,zv.Sekretare e Përgjithshme/MAPL Znj.Leonita Shabani,zv.Sekretare e Përgjithshme/ME Z.Gëzim Sahiti,zv.udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave/MAPL Znj.Ardita Latifi,Zyrtare e lartë për Monitorim të Komunave/MAPL
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z.Besim Imeri, udhëheqës i NJPMNP-së <i>Besim Imeri</i>
NGA/OD/FROM:	Arbërore Bernica-Hasani,analiste/NJPMNP <i>Arbërore Bernica-Hasani</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vlerësimi i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Obiliqit

I nderuar,

Në pajtim me Rregullore (qrk) nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (qrk) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë së Ekonomisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullore (QRK) - Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjesisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, NJPMNP/ME ka pranuar për shqyrtim aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Obiliqit i miratuar me datë 23.12.2021, i pranuar në ME-a nga MAPL me datë 17.01.2022 Nr. prot.02/56, për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në ndërmarrjen Publike Lokale "Kastrioti Sh.A", i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit ,nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Obiliqit me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Mbështetur në ligjin nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike neni 5 paragrafi 2 rregullon "Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar "

Ministria e Ekonomisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës si i tillë është në harmoni me legjislacionin aktual për ndërmarrje publike dhe mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Ekonomisë, mbetet në dispozicion të MAPL dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Respekt!